



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101579/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës.*

**Drejtuar:** **Z. Admir ABRIJA**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve**

**TIRANË**

**Z. Leonard MARKDODA**  
**Drejtor i IEVP-së në Kukës**

**KUKËS**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucioni e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Kukës.

Inspektimi u krye më datë 23.11.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në IEVP Kukës për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të paraburgosur; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të paraburgosurve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e zhvilluar vitin e kaluar më datë 16.12.2020<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shkresë nr.K4/I53-2 prot., datë 31.12.2020 dërgohet "Rekomandime për përmirësimi i kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve në IEVP Kukës".

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet e sistemit penitenciar, grupi i inspektimit u takua me Drejtorin e I EVP Kukës z. Leonard Markdoda, i cili pas prezantimit u informua në lidhje me qëllimin e inspektimit, ambientet që do të inspektohen, intervistat që do të zhvilloheshin me të paraburgosurit, si dhe dokumentacioni që do të verifikohet, një kopje e të cilit do të vihej në dispozicion edhe të grupit të inspektimit.

Grupi i inspektimit kërkoi fillimisht nga Drejtori i I EVP-së një informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve në këtë I EVP, kushtet në të cilën ndodhen ambientet në regjimin e brendshëm, mënyrën e zgjidhjes nga ana e institucionit të kërkesë/ankesave të të paraburgosurve, si dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Nga takimi u evidentua se, bazuar në urdhërin nr.381, datë 19.07.2019 "*Për disa ndryshime në Urdhërin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrisë të Drejtësisë, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale"*, I EVP Kukës klasifikohet institucion paraburgimi.

Kapaciteti fizik i institucionit ishte për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 34 personave të paraburgosur. Në momentin e inspektimit, në ambientet e institucionit ndodheshin 26 të paraburgosur dhe asnjëri prej tyre nuk ishte i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sipas statistikave të raportuara nga stafi i institucionit, për periudhën Qershor–Nëntor 2021, rezultoi se në I EVP Kukës nga muaji Qershori deri në muajin Gusht ka patur mbipopullime dhe deri në 30% të kapacitetit, situatë e cila në muajit në vazhdim ka ardhur në rënie duke u stabilizuar. Dinamika e popullimit të institucionit ka qenë si më poshtë:

- Qershor           46 të paraburgosur
- Korrik            40 të paraburgosur
- Gusht            37 të paraburgosur
- Shtator          31 të paraburgosur
- Tetor            27 të paraburgosur
- Nëntor           27 të paraburgosur

Struktura organike e I EVP-së Kukës përbëhet nga 55 punonjës, nga të cilët 9 janë stafi civil dhe 41 janë punonjës të sigurisë së burgut. Nga informacioni, organika nuk ishte e plotësuar pasi mungonin 2(dy) punonjës, 1(një) "specialist jurist, b/njerëzore, kartelist" dhe 1(një) punonjës policie i rolit bazë. Mungesa e "specialist jurist, b/njerëzore, kartelist", përbënte

shqetësimin kryesor për të paraburgosurit, pasi kërkesat e tyre për asistencë dhe ndihmë juridike, ishin të shumta. Gjithashtu, nevoja e institucionit për jurist/kartelist ishte e domosdoshme, për shkak të dinamikës që ka çdo IEVP në raport me institucione të tjera. Aktualisht, detyrën e juristit e kryente drejtori i IEVP-së, i cili edhe ky vazhdonte të ishte i komanduar.

Problematike në institucion ishte edhe mungesa e mjekut të IEVP-së me kohë të plotë. Aktualisht, mjeku ishte i punësuar me kohë të pjesshme (4 orë në ditë), por efektivisht ndihej mungesa e tij. Nga informacioni rezultoi se, prezenca e mjekut në institucion nuk ishte e përditshme sipas kontratës me IEVP (kjo e evidentuar edhe në listëprezencën e institucionit), duke sjellë për pasojë mungesë dhe vonesa në kryerjen e vizitave mjeksore të të paraburgosurve, në kohën që ata kishin kërkuar një gjë të tillë.

Gjatë inspektimit, grupi i monitorimit inspektoi dhe zbatimin e masave të marra, nga ana e këtij Institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19.

Nga inspektimi u evidentua se, zbatohet protokollin shëndetësor për masat anti Covid-19. Në hyrje të institucionit, punonjësi i shërbimit kryente matjen e temperaturës me termometër digital, si dhe kalohej në urën dizinfektuese, veprime të cilat shënoheshin në një libër të veçantë, si për punonjësit e IEVP-së dhe për vizitorët.

Personeli i administratës dhe punonjësit e sigurisë në regjimin e brendshëm, zbatonin me korrektësi masat mbrojtëse duke mbajtur maskat mbrojtëse dhe ruajtur distancimin fizik dhe social. Në vende të aksesueshme ishin vendosur dizinfektantë për pastrimin e shpeshtë të duarve. Ndërsa, në ambientet e dhomave të të paraburgosurve dhe ato të përbashkëta, nuk mungonte uji i rrjedhshëm dhe ambientet ishin të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Urdhrat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administratës, në hyrje të regjimit të brendshëm, si dhe në këndin e njoftimeve që ndodhej në korridorin e sektorit të banimit të të paraburgosurve.

Sipas një grafiku, çdo javë kryhej dizinfektimi i zyrave të administratës, ambienteve në regjimin e brendshëm si dhomave të banimit, dhomën e veçimit, kuzhinën e institucionit, si dhe dhomën e krijuar për karantinimin e të paraburgosurve në rastet e infektimit nga COVID-19. Ndërsa, dy herë në javë bëhej dizinfektimi i ambienteve të jashtme të institucionit. Dizinfektimi kryhej një nga subjekt privat i linçësuar sipas kontratës me IEVP, si dhe nga Bashkia Kukës.

Stafi i institucionit dhe të paraburgosurit, ishin të informuar me masat kufizuese për periudhën e pandemisë, si dhe me masat mbrojtëse për parandalimin e COVID-19.

Gjatë situatës së pandemisë, por jo vetëm, në IEVP Kukës shqetësuese ka qenë dhe është mungesa e ajrimit të ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe hapësirave të vogla të

ambienteve të brendshme, të cilat nuk mundësojnë ruajtjen e distancimit fizik dhe social midis të paraburgosurve, duke përbërë një rrezik për përhapjen e infeksionit COVID-19.

Aktualisht në I EVP Kukës nuk kishte asnjë rast të infektuar me COVID-19. Procesi i vaksinimit me një dhe dy doza kishte përfunduar në masën 99% të stafit të institucionit. Ndërsa nga të paraburgosurit, vetëm 7(shtatë) prej tyre ishin vaksinuar me dy doza dhe 19(nëntëmbëdhjetë) prej tyre kishin nënshkruar deklarata për refuzimin e vaksinimit, për arsye personale.

Nga ana e drejtuesit dhe stafit të institucionit, grupit të inspektimit ju ofrua akses i plotë brenda Rregullores së Brendshme, për kryerjen e inspektimit në të gjitha ambientet e brendshme të tij, si dhe zhvillimin e intervistave me personat e paraburgosur që vuanin dënimin në këtë institucion.

Nga verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, rezultoi se:

1. Situata e **mbipopullimit** në I EVP Kukës ishte stabilizuar, pasi numri i të paraburgosurve kishte ardhur në rënie gjatë muajve të fundit të këtij viti.
2. Ishte plotësuar rekomandimi, për instalimin e një skaneri urë në ambientet e institucionit, për të bërë të mundur kontrollin e personelit dhe vizitorëve që hyjnë në regjimin e brendshëm, si dhe kontrollin e ushqimeve për të paraburgosurit.
3. Ishte plotësuar rekomandimi, për vënien në funksion të skemës tre palëshe për furnizimin me medikamentet e nevojshme për të sëmurët kronikë, midis I EVP Kukës, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike.
4. Ishte plotësuar rekomandimi, për vënien në funksion të kaldajës për ngrohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit, në përshtatje me kushtet klimaterike.

Ndërkohë, u evidentua se një pjesë e rekomandimeve nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar:

1. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për rikonstuksionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në I EVP Kukës, me qëllim zgjerimin e hapsirave për ajrim dhe dritë natyrale në dhomat e banimit, eliminimin e lagështirës në regjimin e brendshëm, si dhe për krijimin e kushteve normale të punës së stafit të I EVP-së.
2. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas strukturës organike.
3. Për shkak të masave kufizuese në kuadër të emergjencës shëndetësore, ende nuk po lejohen organizime të aktiviteteve kulturore dhe artistike me pjesëmarrjen e gjerë të të paraburgosurve, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre.

4. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për mundësinë e blerjes së një aspiratori për ajrimin në ambientin e kuzhinës të institucionit.

Në lidhje me nevojat për plotësimin e kushteve të të paraburgosurve për jetesë normale, zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese, si dhe për realizimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, Drejtori i IEVP Kukës kishte bërë me dije DPB-në Tiranë, përmes informacioneve të shpeshta mujore ku evidentohen nevojat sipas sektorëve dhe mbështetja buxhetore<sup>2</sup>.

Grupi i inspektimit, në përfundim të vizitës monitoruese e njohu stafin e IEVP Kukës, me gjetjet kryesore dhe problematikat e konstatuara nga inspektimi, të cilat janë kthyer në rekomandime të Institucionit të Avokatit të Popullit për drejtuesit e DPB-së dhe IEVP Kukës.

### **Trajtimi**

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës monitoruese në IEVP Kukës, zhvilloi takime dhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, me qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve në këtë institucion, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo ushtrimit të forcës tej kufijve sikurse parashikohet në aktet normative në fuqi, për këtë qëllim.

Në intervistat me të paraburgosurit, si dhe nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk u konstatuan raste apo pretendime të të paraburgosurve për ushtrim të dhunës fizike apo psikologjike nga punonjësit e policisë së burgut.

Ankesat më së shumti të të paraburgosurve kishin të bënin me mungesën efektive të mjekut, si dhe për vonesa në kryerjen e vizitave mjeksore. Mjeku i institucionit ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme, por nuk paraqitej në punë në oraret e përcaktuar në kontratë dhe kur kërkohet për vizitë mjeksore nga të paraburosurit. Ata detyroheshin të prisnin deri dhe disa ditë mjekun për kryerjen e vizitave mjeksore apo për pajisjen me rekomandime për të kryer vizita mjeksore pranë Spitalit Rajonal Kukës. Ndërsa, për stafin e infermierëve të paraburgosurit nuk kishin vërejtje, pasi ata ishin të disponueshëm në çdo kohë.

Një kërkesë e vazhdueshme e të paraburgosurve e evidentuar edhe nga vitet e kaluara, kishte të bënte me hapjen e njësie tregtare brenda ambienteve të këtij institucioni, për blerjen e produkteve ushqimore apo produkteve të tjera të nevojshme. Kjo kërkesë qëndronte më së shumti për shtetasit e huaj të paraburgosur, të cilët për shkak të largësisë fizike nuk kishin mundësi të takonin familjarët e tyre dhe të merrnin ushqime. Në momentin e inspektimit në këtë institucion ndodheshin 8 shtetas të huaj me origjinë nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, si dhe 1 shtetas me origjinë norvegjeze/kanadeze, në total 9(nëntë) shtetas të huaj.

---

<sup>2</sup> Shkresë nr.334/1 prot., datë 04.11.202, IEVP Kukës drejtuar DPB-së.

Nga informacioni i drejtuesit të këtij institucioni, rezultoi se nuk ka oferta nga subjekte private për hapjen e njësisë tregtare në këtë institucion, për shkak të numrit të ulët të të paraburgosurve.

Të paraburgosurit, ngritën ankesa për nivelin e lagështirës, si dhe mungesën e ajrimit dhe dritës natyrale, pasi godina ndodhet pjesërisht nën nivelin e tokës. Pavarësisht investimit të kryer me fondet modeste të institucionit, lagështia ishte prezente në disa dhoma banimi, si dhe në ambientin e tualetit dhe të dusheve të përbashkëta për larjen e trupit.

Një grup ankesash vijonin të kishin të bënin me mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive, të cilat për shkak të situatës së pandemisë, nuk lejohen të zhvillohen. Por, institucioni ka gjithashtu dhe mungesë të infrastrukturës në ambientin e brendshëm, për zhvillimin e aktiviteteve me pjesmarrjen e gjerë të të paraburgosurve. Sipas tyre, aktiviteti i vetëm që kryhej në këtë institucion, ishte koha e ajrimit dhe lojrat e tavolinës.

### **Masat mbrojtëse**

Nga verifikimi dhe administrimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se, kërkesë/ankesat e të paraburgosurve regjistroheshin në regjistrin përkatës dhe më tej protokolloheshin<sup>3</sup>. Regjistri ishte i sekretuar dhe mbahej nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit pasi plotësonin një formular të kërkesë/ankesave, ja dorëzonin punonjësit të sektorit të çështjeve shoqërore. Punonjësi i edukimit, formularët e kërkesë/ankesave i dërgonte në sekretarinë e institucionit, ku protokolloheshin dhe i kalonin drejtorit të institucionit, i cili u kthente përgjigje me shkrim ose verbalisht të paraburgosurve.

Nga verifikimi i regjistrit të ankesave, ato konsistonin në kërkesa për takime me familjarët, kërkesa për takim me avokatët mbrojtës, vizita mjeksore pranë Spitalit Rajonal Kukës, kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV dhe frigorifer etj., të cilat ishin plotësuar nga institucioni, mbi bazën e shënimeve të kryera në regjistrin e ankesave dhe kërkesave.

IEVP Kukës në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, mbahej në vëzhgim dhe monitorohej nga sistemi i kamerave. Nga 16 kamera të instaluar në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, një pjesë e tyre kishin shikueshmëri të dobët dhe ishin me difekte. Nga sektori i sigurisë së këtij burgu, ishte kërkuar shtimi i numrit të kamerave, për mbulimin edhe të disa ambienteve të tjera, me qëllim për të rritur nivelin e sigurisë së institucionit. Të dhënat që gjeneroheshin nga sistemi i kamerave, administroheshin nga drejtori i institucionit dhe ruheshin në server për një periudhë 3(tre) mujore.

Nga verifikimi i dokumentacionit që mbahej nga Komisioni i pritjes dhe Komisioni i dhënies së masave disiplinore, u evidentua se, procedura e ndjekur nga anëtarët e komisioneve ishte në përputhje me legjislacionin dhe Rregulloren e Përgjithshme të

---

<sup>3</sup> Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Burgjeve. Praktika e ndjekur regjistrohej në formularët dhe regjistrin përkatës, të cilat ishin të protokolluara.

Në mjedisin e regjimit të brendshëm, ndodheshin 2(dy) aparate telefonik që u shërbenin të paraburgosurve për të komunikuar me familjarët dhe të afërmit e tyre. Në intervistat e zhvilluara, të paraburgosurit deklarorin se respektohej numri 2 herë në javë i telefonatave me familjarët, sikurse përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit.

Takimet e të paraburgosurve me familjarët, për shkak të situatës së pandemisë, zhvilloheshin 4(katër) herë në muaj, të ndara në 3(tre) takime online dhe 1(një) takim fizik, në një prej dhomve që ndodhej në regjimin e brendshëm për këtë qëllim.

Në regjimin e brendshëm ndodhej një dhomë ku ishte vendosur një monitor (kompjuter) për lidhjen me “skype” me familjarët, si dhe një monitor tjetër ndodhej në një dhomë jashtë këtij regjimi, që u shërbente familjarëve për të komunikuar me të paraburgosurit.

Nga intervistat me të paraburgosurit, nuk pati ankesa për mosrespektimin e numrit të takimeve me familjet, por ata kishin kërkesa për shtimin e numrit të takimeve fizike me familjarët, pasi në shumicën e rasteve ishin të vaksinuar ose kishin kryer tamponin me rezultatin “negativ”, kur paraqiten në takime me të paraburgosurit.

Në regjimin e brendshëm ndodhej një ambient kulturi, i cili ishte funksional dhe përdorej kryesisht nga besimtarët myslimanë, por dhe ata të krishterë sipas rastit. Gjatë periudhës së pandemisë, për shkak të kufizimeve nuk kryheshin rite fetare me përfaqësues të komunitetit mysliman ose të krishterë, pasi nuk lejohen grumbullimet dhe nuk mund të ruhet distancimi fizik dhe social midis të paraburgosurve.

Gjatë inspektimit u evidentua se në IEVP Kukës, në një dhomë që ndodhej në hyrje të regjimit të brendshëm, ishte instaluar një skaner urë, e cila shërbente për kontrollin e personelit dhe vizitorëve që hyjnë në regjimin e brendshëm, si dhe për të rritur sigurinë e institucionit.

### **Kushtet materiale**

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës monitoruese në IEVP Kukës, i kushtoi një interes të veçantë plotësisht të kushteve materiale në funksion të të paraburgosurve, për respektimin e standardeve normale për jetesë, si dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, me qëllim rehabilitimin e tyre.

Kushtet materiale në regjimin e brendshëm të institucionit ishin në përgjithësi të përmirësuar, pavarësisht pozicionit të disfavorshëm në të cilën ndodhet godina në nivelin e tokës. Nga ana e institucionit, ishin kryer disa investime me fondet e tyre, për reduktimin e nivelit të lagështirës në ambientet e dhomave, si dhe në tualetet e dushet e përbashkëta.

Ambientet e banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishte krijuar një ambient i veçantë për ajrimin e të paraburgosurve.

Kubatura e dhomave ishte më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja banimit ishte më pak se 4 m<sup>2</sup>, për çdo të burgosur<sup>4</sup>. Përmasat e dhomave ishin të vogla dhe ishin të papërshtatshme. Në dhoma ishin akomoduar 1, 2 dhe në dy dhoma ishin 3 persona.

Në këto kushte, duke vlerësuar kushtet e klimës të zonës, hapësirës së nevojshme për jetesë për person, mungesës së ajrimit, ndriçimit, mjediseve të pamjaftueshme në regjimin e brendshëm në këtë institucion, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, përgjithësisht nuk garantojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe nuk plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike sipas standardeve të të paraburgosurve.

Dhomat për banim ishin të kompletuara me materiale për fjetje si krevat, dyshek, batanie e çarçaf për çdo të paraburgosur. Hapsirat dhe përmasat e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin shtimin e komoditave dhe të rafteve për mbajtjen e ushqimeve dhe sendeve personale. Ato ruheshin nga të paraburgosurit në çanta dhe ishin të vendosura në dysheme.

Në regjimin e brendshëm, ndodhej një klasë edukimi e cila njëkohësisht shërbente edhe si bibliotekë, në të cilën zhvilloheshin nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore këshillime individuale dhe trajtime psiko-sociale me të paraburgosurit, në mungesë të aktiviteteve dhe veprimtarive të përbashkëta, për shkak të situatës së emegjencës shëndetësore nga COVID-19.

Gjithashtu, u evidentua se dritaret e dhomave të banimit ishin me përmasa të vogla 80x60 cm, të cilat **nuk** mundësonin ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për jetesë të të paraburgosurve. Në pjesën e jashtme ato ishin të përforcuara me skara hekuri. Mundësia e zgjerimit të dritareve është e pamundur, për shkak të strukturës dhe pozicionit që godina e regjimit të brendshëm ndodhet nën nivelin e tokës.

Kushtet materiale në regjimin e brendshëm të I EVP Kukës, në tërësinë e tyre bien në kundërshtim me Rregullin 13 “Rregullat e Mandelës”, të miratuara nga OKB, ku përcaktohet shprehimisht se *“Hapsirat e akomodimit për të burgosurit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore, vëmëndje e veçantë duhet t’u kushtohet kushteve klimatike dhe veçanërisht ajrosjes, hapësirës minimale për banim, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit”*.

Në regjimin e brendshëm ndodhej dhoma e cila shërbente për takime të të paraburgosurve me avokatët mbrojtës, prokurorin e çështjes ose oficerë të policisë gjyqësore, e cila ishte e rregullt, e pastër dhe e lyer, e pajisur me tavolinë pune dhe karrige e stol për qëndrimin ulur të personave. Dhoma nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave

---

<sup>4</sup> Neni 33 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.



IEVP Kukës kishte një dhomë observimi dhe një dhomë veçimi, të cilat ishin të kompletuara me nga një krevat dhe materiale për fjetje, në të njëjtat kushte me dhomat e tjera. Në momentin e inspektimit në dhomën e observimit ndodhej një i paraburgosur ardhur rishtaz për përshtatje, në pritje për tu sistemuar në dhomat e banimit. Në dhomën e veçimit nuk kishte asnjë të paraburgosur me masë disiplinore.

Furnizimi me ujë mundësohej nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit të Kukësit përgjatë 24 orëve. Nga ana e institucionit ishin siguruar dhe 2 çisterna rezervë, të cilat mundësonin furnizimin me ujë pa ndërprerje, në rastet e difekteve të ujësjellësit.

Ambientet e brendshme dhe të jashtme të I EVP Kukës furnizohehin me energji elektrike nga rrjeti elektrik i qytetit dhe në rast ndërprerje të energjisë elektrike nga rrjeti, ajo mundësohej me gjenerator që furnizonte njëkohësisht ambientet e I EVP-së dhe të DVP Kukës, pasi këto institucione ndodhen brenda të njëjtit territor.

Ambientet e Institucionit ishin të dezinfektuara dhe nuk u evidentua prania e insekteve. Për larjen e materialeve të fjetjes, institucioni kishte funksionale një lavatriçe dhe një tharëse. Ndërsa, rrobat e trupit laheshin nga vetë të paraburgosurit ose dërgoheshin pranë familjarëve të tyre. Kjo, për shkak dhe të mungesës të ambienteve për hapjen dhe tharjen e rrobave.

Në I EVP Kukës mungojnë mjediset e jashtme të hapura, të cilat mund të përdoren për aktivitete sportive si futboll, basketboll, etj. I vetmi mjedis i hapur ishte ai i ajrimit, i cili ishte i kufizuar në hapësirë dhe nuk ofronte asnjë mundësi argëtimi me aktivitete sportive, përveç lojërave të tavolinës. Për periudhën e pandemisë dhe në vazhdim, aktivitetet me karakter sportiv dhe kulturor, me pjesmarrjen e të paraburgosurve, vijonin të ishin ndërprerë deri në përfundim të emergjencës shëndetësore.

Kuzhina e institucionit ndodhej jashtë ambientit të regjimit të brendshëm. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të vogël, por mbahej pastër nga personeli i saj. Gatimi i ushqimit dhe ruajtjen e produkteve ushqimore kryheshin në të njëjtin ambient. Gatimi kryhej me sobë me energji elektrike, për të paraburgosurit e I EVP-së dhe njëkohësisht për personat e ndaluar/arrestuar në dhomat e sigurisë të DVP Kukës, për 3 vakte ushqimore. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme dhe konsumohej nga të paraburgosurit. Në rastet kur kishte të sëmurë me diabet, ushqimi gatuhej më vete.

Personeli i kuzhinës sipas organikës përbëhej nga 2 punonjës. Në një stendë të vendosur në mur ishin të afishuara librezat shëndetësore të kuzhinerëve, të cilat ishin të përditësuara, si dhe menuja javore me kuotat ditore dhe vlerat kalorike, të cilat rezultuan të ishin brenda normativave. Gjatë inspektimit u konstatua se kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike.

Nga inspektimi u evidentua se, në kuzhinë **mungonte** aspiratori për të evituar erërat, tymrat dhe aromat nga gatimi i ushqimit, si dhe një frigorifer banak për ruajtjen e produkteve të mishit, pasi frigoriferi ekzistues ishte i vjetëruar dhe me kubaturë shumë të vogël.

Ngrohja në ambientet e regjimit të brendshëm realizohej me kaldajë qëndrore, e cila ishte venë në funksionim, por kushtet klimaterike të ftohta të zonës për periudhë të gjatë kohore, si dhe niveli nën tokë i godinës së regjimit të brendshëm, bëjnë të pashmangshme praninë e lagështirës në disa dhoma, ndaj dhe ngrohja e ambienteve nuk përballohej nga kaldaja. Sipas nevojave, të parburgosurve ju ishte lejuar dhe futja e ngrohëseve elektrike për periudhën e dimrit.

Një problem i evidentuar dhe në inspektimin e mëparshëm në regjimin e brendshëm të këtij institucioni, kishte të bënte me dyert e dhomave të cilat ishin të amortizuara dhe të vjetëruara. Është e nevojshme zëvendësimi i dyerve të brendshme, me dyer të reja dhe skarë hekuri të cilat të garantojnë sigurinë, por edhe ajrimin e dhomave të banimit.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve, duke përfshirë zgjimin, rregullimin e pastrimin në dhomat e banimit dhe ambientit të përbashkët, koha e ajrimit dhe e takimeve me punonjësit psiko-social, ishte e afishuar në korridor dhe në klasën e edukimit.

Aktivitetet zhvilloheshin me grupe të vogla në bibliotekë dhe kryesisht ishin lojëra tavoline. Punonjësi i sektorit të çështjeve shoqërore, kishte hartuar programe individuale këshillimi dhe trajtimi psiko-social me të parburgosurit. Gjithashtu, sipas programeve mujore të këtij sektori, me të parburgosurit ishin zhvilluar tema dhe recensione të librave të cilat konsideroheshin si aktivitete informuese dhe edukative. Masat kufizuese në kuadër të zbatimit të protokollit shëndetësor për parandalimin e pandemisë, kanë bërë të pamundur zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe edukative të përbashkëta të të parburgosurve.

Në institucion nuk kishte persona me probleme të shëndetit mendor, ndërsa për të parburgosurit e ardhur rishtas në këtë IEVP, kishte program të veçantë të pritjes për këtë kategori.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se, për çdo të parburgosur ishin krijuar dosje psiko-sociale, të cilat ishin të plotësuara rregullisht dhe të përditësuara, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të parburgosurit, me vlerësimet e tre mujorëve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Sektori i edukimit kishte në organikë vetëm 1(një) specialist të kujdesit social.

### **Shërbimi shëndetësor**

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek dhe 3 infermierë. Aktualisht, mjeku punonte me kontratë me kohë të pjesshme, 4 orë në ditë, por ai nuk ishte prezent në institucion çdo ditë, duke krijuar probleme me stafin dhe të parburgosurit e këtij institucioni. Nisur nga ankesat e lartpërmendura të të parburgosurve, por dhe pretendimet e Drejtorit të institucionit për disiplinën në punë, del nevoja e zëvendësimin e mjekut aktual me mjek tjetër, qoftë edhe me kohë të pjesshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua se regjistrat e terapisë ditore, marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, kartelave dhe ngjarjeve të rënda ishin të plotësuar dhe mbajtur në mënyrë të rregullt. Kartelat mjekësore të të parburgosurve, mbaheshin me çelës në zyrën e mjekut/infermierit, e cila shërbente njëkohësisht edhe si zyrë për financën dhe logjistikën.

Dhoma e infermierisë, ndodhej në regjimin e brendshëm dhe ishte e rregullt dhe e mirëmbajtur, e pajisur me shtrat, tavolinë pune dhe rafte për mbajtjen e medikamenteve dhe regjistrat ku evidentoheshin rastet e dhënies së ndihmës mjeksore për të parburgosurit.

Furnizimi me medikamente për pacientët kronikë kryhej sipas skemës tre palëshe midis IEVP-së, degës së FSKSH-së Kukës dhe Depos Farmaceutike. Përveç kësaj skeme, IEVP Kukës furnizohej me medikamente edhe nga DPB. Në rastet e furnizimit me medikamente të urgjencës, përdorej fondi i venë në dispozicion të institucionit për këtë qëllim. Kur ilaçet siguroheshin nga familjarët ato administroheshin nga infermierët e turnit dhe u jepeshin të parburgosurve (të sëmurë me sëmundje kronike), sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Të gjithë të parburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Asgjësimi i ilaçeve të skaduara bëhej me komision dhe evidentohej në procesverbalet përkatëse dhe rregjistrohej në mënyrë filmike.

Në këtë institucion mungonte autoambulanca, por institucioni kishte një bashkëpunim të mirë me spitalin rajonal Kukës, për rastet e vizitave mjeksore të mjekëve specialist, si dhe për trajtimin e rasteve të urgjencave. Në Spitalin Rajonal Kukës ishte e përshtatur një hapësirë me dy dhoma, me hyrje më vete e dedikuar për shtrimin e personave të parburgosur, e cila plotësonte parametrat e sigurisë.

Gjatë situatës së pandemisë, personat e infektuar me COVID-19, sipas protokollit dhe procedurave të miratuar nga sektori i shëndetësisë pranë DPB-së Tiranë, dërgohen për trajtim në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) në Tiranë, por në IEVP Kukës nuk ka patur asnjë rast të identifikuar.

Shërbimi i stomatologjisë për të parburgosurit mbulohej me shërbim në poliklinikën e qytetit të Kukësit ose në shërbim privat me rekomandimin e mjekut të institucionit. Për këto raste, Institucioni mbulonte shpenzimet e lëvizjes.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave*

dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për planifikimin e fondeve buxhetore, në lidhje me rikonstrukcionin e plotë të godinës të regjimit të brendshëm të IEVP-së Kukës, për të siguruar ambiente të përshtatshme për trajtimin dinjitoz dhe kushte normale për jetesë të të paraburgosurve.
2. Të merren masa të menjëherëshme, për zëvendësimin e mjekut aktual me mjek me kohë të plotë ose të pjesëshme, sipas strukturës organike të IEVP Kukës të miratuar. Gjithashtu, të sigurohet prezenca në punë e mjekut, qoftë dhe me kohë të pjesshme, sipas kontratës së nënshkruar me IEVP Kukës, 4 orë në çdo ditë.
3. Të merren masat e nevojshme, për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të alternuara me aktivitete dhe takime me të paraburgosurit, për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative, në përshtatje me kushtet e institucionit dhe duke respektuar masat e protokollit anti COVID-19.
4. Të merren masat e nevojshme, për pajisjen e dhomave të të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.
5. Marrjen e masave të menjëherëshme, për blerjen e aspiratorit për ajrim në kuzhinën e institucionit, si dhe të një frigoriferi me kapacitet për të ruajtur produktet e mishit dhe produkteve ushqimore.
6. Marrjen e masave të menjëherëshme, për plotësimin e vendit vakant të “specialistit jurist, b/njerëzor dhe kartelist”.
7. Të merren masa të menjëherëshme, për shtimin e numrit të kamerave të sigurisë, si dhe rregullimin e kamerave ekzistuese, për garantimin e sigurisë fizike të institucionit, por dhe për parandalimin e rasteve të keqtrajtimit ndaj të paraburgosurve.
8. Deri në rikonstrukcionin e plotë të godinës, të merren masa të menjëherëshme për eliminimin e lagështirës në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dat` 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**